



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1047 / prot.

Tiranë më 22.9.2017

V E N D I M

Nr. 89, datë 22.9.2017

PËR

LEJIMIN E TRANSFERIMIT NDËRKOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 9 dhe pikës 1 të nenit 26 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës administruar me nr. 1047 prot, datë 24.07.2017, për pajisje me autorizim për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale nga transferuesi **Zyra e përfaqësisë së GlaxoSmithKline (GSK) Export Limited në Shqipëri** në marrësin **Wipro Limited, WNS Global Services Limited në Indi**;

K O N S T A T O V A:

Subjekti kontrollues, Zyra e përfaqësisë së GlaxoSmithKline (GSK) Export Limited në Shqipëri ka kërkuar nga Autoriteti i Komisionerit pajisjen me autorizim për transferimin e të dhënave personale në marrësin Wipro Limited, WNS Global Services Limited vendosur në Indi.

Sipas deklarimeve të subjektit në *Formularin e Aplikimit për Aprovimin e Transferimit të të Dhënave Personale në një Shtet që nuk ka Nivel të Mjaftueshëm të Mbrojtjes së të Dhënave*, administruar pranë KDIMDP, transferimi që kërkohet të autorizohet nga Autoriteti i Komisionerit përmban elementët e mëposhtëm:

Kategoria e të dhënave objekt transferimi:

1. Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja). Shteti ku do të realizohet transferimi: Indi.

Kategoria e subjekteve të cilëve u transferohen të dhëna personale janë: Nënpunës dhe punëmarrës.

Frekuenca e Transferimit është: Periodikisht dhe sa herë të jetë e nevojshme.

Qëllimi i transferimit, citojmë: “Garantimi që pyctjet mjekësore nga Personeli i Kujdesit Mjekësor kanë marrë përgjigje njësoj në çdo shtet të botës ku ka zyrë të GSK-së”.

Ndërkohë në Rubrikën 7, të Formularit të Aplikimit “*Rrethanat lidhur me përpunimin*” subjekti transferues ka deklaruar, citojmë: “Të dhënat personale do të mblidhen në mënyrë elektronike në një server nga përpunuesi i të dhënave.

Natyra e përpunimit të të dhënave do të konsistojë në sigurimin e funksionimit operacional dhe stabilitetit të sistemit në të cilin përpunohet informacioni. Vlerësimin, implementimin dhe rishikimin e ndryshimeve të sistemit në të cilin përpunohen të dhënat. Sigurimin se dokumentat vendore ruhen në të njëjtën mënyrë si ato të partnerëve në nivel global, futja e të dhënave të krijuara në sistem. Stabiliteti i sistemit dhe monitorimi i sistemit në lidhje me përpunimin e të dhënave, etj”.

Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave, citojmë: “Të dhënat do të ruhen jo më gjatë se përfundimi i veprimtarisë të GlaxoSmithKline (GSK) Export Limited në Shqipëri”.

Në bazë të Vendimit të Komisionerit Nr. 8, datë 31.10.2016 “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”, India nuk është në listën e vendeve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.

Në këto kushte në zbatim të nenit 9 pika 1, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, subjekti kontrollues Zyra e përfaqësisë së GlaxoSmithKline (GSK) Export Limited në Shqipëri është në kushtet ku ky transferim duhet kryer pas marrjes së Autorizimit nga Komisioneri mbi ligjshmërinë e realizimit të tij.

Në mbështetje të dokumentacionit të paraqitur nga kontrolluesi dhe studimi i përmbajtjes së tyre rezulton që ky transferim të dhënash personale të jetë në përputhje me respektimin e mbrojtjes së të dhënave personale sipas akteve ndërkombëtare dhe vendase, dispozitat e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 41, datë 13.06.2014 për “Lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.

Sa më sipër, kërkesa për marrjen e autorizimit nga Komisioneri për transferimin e të dhënave personale nga kontrolluesi Zyra e përfaqësisë së GlaxoSmithKline (GSK) Export Limited në Shqipëri plotëson kërkesat ligjore për t’u pajisur me Autorizim për transferimin e të dhënave personale të kërkuara;

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, shkronja b, c nenit 9, pika 2 dhe nenit 26 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;

V E N D O S A :

1. Lejimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale nga kontrolluesi Zyra e përfaqësisë së GlaxoSmithKline (GSK) Export Limited në Shqipëri, si më poshtë:

Kontrolluesi Zyra e përfaqësisë së GlaxoSmithKline (GSK) Export Limited në Shqipëri lejohet të transferojë tek marrësi i të dhënave Wipro Limited, WNS Global

Services Limited e vendosur në Indi periodikisht dhe sa herë të jetë e nevojshme, të dhënave personale punëmarrësve dhe nëpunësve, si më poshtë:

- Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja).
- 2. Të dhënat e cituara më sipër do të transferohen vetëm për qëllimin e deklaruar nga transferuesi në Formularin e Aplikimit për Autorizim mbi Transferimin e të Dhënave Personale, të paraqitur pranë Komisionerit dhe që ka të bëjë me garantimin që pyetjet mjekësore nga Personeli i Kujdesit Mjekësor kanë marrë përgjigje njësoj në çdo shtet të botës ku ushtron veprimtarinë GSK.
- 3. Të dhënat personale të lejuara për t'u transferuar (parashikuar në pikën 1), nuk do të ruhen më gjatë se përfundimi i veprimtarisë të GlaxoSmithKline (GSK) Export Limited në Shqipëri.
- 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u dha sot më datë 22/9 2017

